

Ε

Ε

R

MBLEDHJE BORDI DHE VENDIME

NË VAZHDIM DO TË LEXONI MBI:

- GAZIN NATYROR fq. 5
- ALPEX fq. 4
- SEE CAO fq. 9
- ANKESAT fq. 8
- VEPRIMTARITË
NDËRKOMBËTARE fq. 10
etj.

Puna e Entit Rregullator të Energjisë, në të gjitha aspektet nën fushën e përgjegjësisë së saj finalizohet me mbledhjet në të cilat Bordi i Komisionerëve, së bashku me grupet e punëve, diskutojnë, reflektojnë dhe dalin me vendimmarrjet respektive të tilla si ato për përcaktimin e tarifave dhe çmimeve në tregun e rregulluar, shqyrtimin e aplikimeve për licensim, zgjidhjen e mosmarrëveshjeve si dhe zhvillimin e kuadrit rregullator.

Gjatë vitit 2022 ERE ka zhvilluar 64 mbledhje, në të cilat shpesh herë kanë marrë pjesë edhe palë të interesuara apo media të ndryshme, sipas kërkesës. Kësaj të fundi i është ofruar mundësia për të ndjekur në mënyrë të drejtëpërdrejtë këto mbledhje nëpërmjet platformës ZOOM. Këto mbledhje janë reflektuar në 361 vendime të marra nga Bordi i ERE-s gjatë vitit 2022.

LICENCIME

Çdo person juridik, që kryen një veprimtari në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror, duhet të pajiset me licencën përkatëse, të lëshuar nga ERE, në përputhje me përcaktimet e ligjit 43/2015 për Sektorin e Energjisë Elektrike, i ndryshuar dhe atë 102/2015 Për Sektorin e Gazit Natyror, i ndryshuar. Gjatë vitit 2022 nga ERE janë licencuar në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike 22 subjekte. fq. 2


TARIFA & ÇMIME

Një pjesë mjaft të rëndësishme dhe me shumë interes publik, të punës që bëhet në ERE, zë përcaktimi i tarifave dhe çmimeve të energjisë. Sic do të reflektohet dhe më poshtë, disa prej këtyre tarifave përcaktohen me një bazë periodike, dhe disa në varësi të situatës energjitike kombëtare dhe ndërkombëtare. fq. 3

SEANCA DËGJIMORE

Gjatë vitit që lamë pas janë zhvilluar 49 seanca dëgjimore të organizuara nga ERE, me qëllim marrjen e qëndrimit të palëve dhe zgjidhjen përfundimtare apo adresimin e zgjidhjes së ankesës apo kërkesave të palëve të interesit. fq. 7

LICENCA GJATË VITIT 2022



Grafiku 1 – Licencat e dhëna nga ERE gjatë vitit 2022

Çdo person juridik, që dëshiron të kryejë një veprimtari në sektorin e energjisë elektrike apo gazit natyror, duhet të pajiset me licencën përkatëse, të lëshuar nga ERE, në përputhje me përcaktimet e ligjit 43/2015 për Sektorin e Energjisë Elektrike, i ndryshuar apo atë 102/2015 Për Sektorin e Gazit Natyror, i ndryshuar. ERE lëshon licencë për veprimtaritë e mëposhtme:

Për energjinë elektrike

- prodhimin e energjisë elektrike;
- operimin e sistemit të transmetimit të energjisë elektrike;
- operimin e sistemit të shpërndarjes të energjisë elektrike;
- furnizimin e energjisë elektrike;
- tregtimin e energjisë elektrike;
- operimin e tregut të energjisë elektrike.

Dhe për gazin natyror:

- transmetim të gazit natyror;
- shpërndarje të gazit natyror;
- furnizim të gazit natyror;
- tregtim të gazit natyror;
- operim në hapësirat e depozitimit të gazit natyror;
- operim në impiantet e GNL-së;
- funksionimin e operatorit të tregut të gazit natyror.
- operimin në impiantet e GNL-së me përmasa të vogla;
- operimin në impiantet e GNK-së me përmasa të vogla.”

LICENCIME

Gjatë vitit 2022 nga ERE janë licencuar në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike 22 subjekte nga të cilat 15 për prodhimin e energjisë elektrike nga centralet Fotovoltaike të pozicionuara kryesisht në Qarkun e Fierit, 6 HEC dhe 1 TEC. Në total gjatë vitit 2022 kapaciteti prodhues i energjisë elektrike nga impiantet e vënanë punë është rritur me 289.392 MW, nga të cilat 62.249 MW nga prodhimi i energjisë elektrike nga burimet hidrike dhe 227.143 MW nga prodhimi i energjisë elektrike nga burimet fotovoltaike.

Në grafikun e mësipërm janë të ndara në përqindje numri i licencave të dhëna jo vetëm për veprimtarinë e prodhimit, por dhe në veprimtarinë e furnizimit (4), të tregtimit (16) si dhe të operimit të tregut të energjisë elektrike (1), me një total prej 43 licencash të dhëna për vitin 2022.

ENTIT RREGULLATOR I ENERGJISË

NEWSLETTER

Ndër tarifatat që përcaktohet me intervale mujore janë çmimet e shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit. Këto çmimet aplikohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit (funksion që aktualisht ushtrohet nga ana e Furnizuesit të Shërbimit Universal, FSHU) për të gjithë konsumatorët në nivelet e tensionit 6kV, 10kV, 20kV dhe 35kV, që nuk kanë arritur të gjejnë një furnizues në treg të lirë dhe marrin shërbimin e furnizimit në kushtet e shërbimit të furnizimit të mundësisë së fundit. Për vitin 2022, çmimi mesatar për konsumatorët të lidhur në nivelin e tensionit 35kV ka qënë 31.84 Lekë/kWh dhe për konsumatorët të lidhur në nivelet e tensionit 6kV, 10kV dhe 20kV ka qënë 18.75 Lekë/kWh. Këto çmime janë reflektuar në vendimet e Bordit të Komisionerëve, siç mund ti gjeni në mënyrë të pëmbledhur në foton e bashkëngjitur (ose duke klikuar [këtu](#)).

Gjithashtu, ndër vendime të tjera të rëndësishme të marra nga Enti Rregullator i Energjisë, gjatë vitit të fundit mund të përmendim vendimet mbi përcaktimin e tarifave të transmetimit, shpërndarjes, furnizuesit të shërbimit universal, çmimit vjetor të blerjes së energjisë elektrike që do tu paguhet prodhuesve me përparësi për vitin 2023, si dhe çmimi i blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme nga dielli me fuqi të instaluar deri në 2 MW për vitin 2022. Sa më sipër, mund ti gjeni në mënyrë të pëmbledhur në figurën më poshtë:

Çmimi i shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit

VITI	VENDIMI	NIVELI I TENSIONIT	ÇMIMI I SHITJES (Lekë/kWh)	
2022	Janar	Vendimi Nr. 75, Datë 13.04.2022	35 kV	32.76
			20 kV	18.80
			10 kV - 6 kV	19.69
	Shkurt	Vendimi Nr. 76, Datë 13.04.2022	35 kV	32.85
			20 kV	18.80
			10 kV - 6 kV	19.69
	Mars	Vendimi Nr. 77, Datë 13.04.2022	35 kV	32.92
			20 kV	18.80
			10 kV - 6 kV	19.69
	Prill	Vendimi Nr. 105, Datë 19.05.2022	35 kV	32.72
			50 kV	18.80
			10 kV - 6 kV	19.69
	Maj	Vendimi Nr. 148, Datë 10.06.2022	35 kV	32.14
			20 kV - 10 kV - 6 kV	18.26
	Qershor	Vendimi Nr. 173, Datë 07.07.2022	35 kV	31.75
			20 kV - 10 kV - 6 kV	18.26
	Korrik	Vendimi Nr. 207, Datë 17.08.2022	35 kV	31.20
			20 kV - 10 kV - 6 kV	18.26
	Gusht	Vendimi Nr. 229, Datë 12.09.2022	35 kV	31.29
	Gusht - Dhjetor		20 kV - 10 kV - 6 kV	18.26
	Shtator	Vendimi Nr. 261, Datë 14.10.2022	35 kV	31.15
	Gusht - Dhjetor	Vendimi Nr. 229, Datë 12.09.2022	20 kV - 10 kV - 6 kV	18.26
	Tetor	Vendimi Nr. 287, Datë 10.11.2022	35 kV	31.50
	Gusht - Dhjetor	Vendimi Nr. 229, Datë 12.09.2022	20 kV - 10 kV - 6 kV	18.26
Nëntor	Vendimi Nr. 318, Datë 12.12.2022	35 kV	31.21	
Gusht - Dhjetor	Vendimi Nr. 229, Datë 12.09.2022	20 kV - 10 kV - 6 kV	18.26	
Dhjetor	Vendimi Nr. 05, Datë 16.01.2023	35 kV	30.59	
Gusht - Dhjetor	Vendimi Nr. 229, Datë 12.09.2022	20 kV - 10 kV - 6 kV	18.26	

Tabela 1 – çmimet e shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit

**TARIFA DHE ÇMIME TË
MIRATUARA NGA ERE**

www.ere.gov.al

Me shumë interes nga organet politikbërëse, partnerët vendas si dhe sidomos publiku, gjatë vitit që çuam pas, ishte çmimi i shitjes së energjisë elektrike për konsumatorin familjar, i cili pas diskutimesh të shumta në përpjekje për të gjetur kompromisin më të mirë qoftë për konsumatorin, por dhe duke mbajtur në mendje faktin që vendi (rajoni por dhe shumë vende të Europës) ndodhet në një situatë emergjence në sektorin energjistik (VKM nr. 584, datë 08.10.2021 “Për shpalljen e gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike”), synimi i përbashkët i ERE dhe Qeverisë Shqipëtare, ishte ndërgjegjësimi mbi përdorimin me kursim të energjisë elektrike, i cili u arrit pa kaluar në kufizime dhe ndryshime të çmimit të sipërpërmendur. Ky faktor gjatë vitit 2022, por sidomos gjatë tremujorit të fundit të këtij viti ngriti polemika dhe diskutime dhe na ka mësuar, që vetëm duke gjetur gjuhën e bashkëpunimit me të gjitha hallkat e përfshira, mund të arrihet në zgjidhje pa prekur një faktor kyç për konsumatorin familjar, siç është çmimi i energjisë elektrike.

Nr.	Nr. Vendimi	Data	Vendimi
1	72	13.04.2022	MIRATIMIN E TARIFËS SË TRANSMETIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE PËR PERIUdhËN 2022-2024
2	73	13.04.2022	MIRATIMIN E TARIFAVE TË SHËRBIMIT TË SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE SIPAS NIVELIT TË TENSIONIT, PËR PERIUdhËN 1 MAJ – 31 DHJETOR 2022
3	74	13.04.2022	VLERËSIMET E ERE PËR KOSTOT E AKTIVITETIT TË FURNIZUESIT TË SHËRBIMIT UNIVERSAL PËR PERIUdhËN 01.05.2022 – 31.12.2022
4	166	28.06.2022	PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË BLERJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE TË PRODHUAR NGA BURIMET E VOGLA TË RINOVUESHME NGA DIELLI ME FUQI TË INSTALUAR DERI 2 MW PËR VITIN 2022
5	324	14.12.2022	LËNIEN NË FUQI TË VENDIMIT TË BORDIT TË ERE-S NR. 73, DATË 13.04.2022 “MBI MIRATIMIN E TARIFAVE TË SHËRBIMIT TË SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE SIPAS NIVELIT TË TENSIONIT, PËR PERIUdhËN 1 MAJ – 31 DHJETOR 2022”
6	325	14.12.2022	LËNIEN NË FUQI TË VENDIMIT TË BORDIT TË ERE-S NR. 74, DATË 13.04.2022 “MBI VLERËSIMET E ERE PËR KOSTOT E AKTIVITETIT TË FURNIZUESIT TË SHËRBIMIT UNIVERSAL PËR PERIUdhËN 01.05.2022 – 31.12.2022”
7	326	14.12.2022	LËNIEN NË FUQI TË TARIFËS SË PËRKOHSHME TË TRANSMETIMIT TË GAZIT NATYROR NGA SHOQËRIA ALBGAS SH.A. PËR VITIN 2023”
8	327	14.12.2022	MIRATIMIN E ÇMIMIT VJETOR TË BLERJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE QË DO T’U PAGUHET PRODHUESVE EKZISTUES ME PËRPARËSI PËR VITIN 2023


Tabela 2 – Lista e vendimeve të ERE mbi përcaktimet e tarifave dhe çmimeve

RREGULLAT DHE PROCEDURAT E BURSËS SHQIPTARE TË ENERGJISË ELEKTRIKE (ALPEX)

Enti Rregullator i Energjisë për Shqipërinë (ERE) zhvilloi një mbledhje të përbashkët me Zyrën e Rregullatorit për Energji për Kosovën (ZRRE), në datën 27 dhjetor 2022, në Prishtinë, me qëllim shqyrtimin e Rregullave dhe Procedurave të Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike (ALPEX) dhe miratimin e tyre. Miratimi i këtyre rregullave i hap rrugën bërjes efektive të platformës së tregtimit dhe është një hap i madh përpara në krijimin e tregut rajonal të energjisë të Ballkanit Perëndimor. Nga efikasiteti i saj do të përfitojnë konsumatorët e Kosovës dhe Shqipërisë por edhe i tërë rajoni si pjesë e iniciativave të përbashkëta. Ky proces i hapi rrugën realizimit të këtij takimi pasi vendosi "Fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së Shoqërisë ALPEX sh.a., dhe të OST sh.a., "Për Miratimin e Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike" në vijim të së cilës u zhvilluan seanca konsultative të përbashkëta me palët e interesuara.

Finalizimi i këtij procesi është paraprirë nga Vendimi i datës 27.10.2022 i Bordit të ERE-s dhe memorandumet e bashkëpunimit ndërmjet OST, KOSTT, ERE dhe ZRRE për bashkimin e tregut të energjisë elektrike për ditën në avancë. Në linjë me Memorandumin e Mirëkuptimit të WB6, në datën 21 tetor 2021 u nënshkrua një tjetër Marrëveshje Kornizë midis OST, KOSTT, ERE dhe ERO për bashkimin (coupling) e tregut të ditës në avancë të energjisë elektrike dhe brenda së njëjtës ditë. Qeveritë e Shqipërisë dhe Kosovës janë palë nënshkruese të Traktatit të Komunitetit të Energjisë dhe janë zotuar në krijimin dhe funksionimin e një tregu konkurrues dhe transparent të energjisë elektrike, ndaj modelet e tregjeve në të dyja vendet parashikojnë që nëpërmjet ALPEX të zbatohet Modeli i Synuar Evropian i Tregut.

ALPEX pritet të fillojë me operimin e tregut të ditës në avancë në Shqipëri dhe gjithashtu ka nisur trajnimin e tregtarëve për tregtimin në treg si dhe procesin e Dry Run gjatë së cilit do të shihen dhe mënyra e funksionimit të këtij tregu si dhe njohja e palëve me proceset e tregtimit të produkteve në këtë bursë. Roli i rregullatorëve do të jetë mbikqyrja e këtij procesi dhe përfundimi i tij me sukses për të përmbushur detyrimet e ndërmarra nga Shqipëria në kuadër të Traktatit të Komunitetit të Energjisë. Ky proces u mbështet nga USAID, partner strategjik i të dy enteve rregullatore ERE dhe ZRRE.





GAZI NATYROR

Për sa i përket sektorit të Gazit natyror, si një aktivitet me rëndësi në punë e institucionit, gjatë vitit që lamë pas, vlen për tu përmendur miratimi mbi ndarjen e kapaciteteve për zgjerimin e TAP.

Autoritetet Rregullatore të Shqipërisë (ERE), Greqisë (RAE) dhe Italisë (ARERA) miratuan së bashku rregullat për fazën e parë detyruese të procesit të rritjes së kapacitetit të Gazsjellësit Trans Adriatik (TAP). Procesi u drejtua në koordinim ndërmjet Operatorëve të Sistemit të Transmetimit fqinjë, TAP, SNAM Rete Gas dhe DESFA, sipas Rregullores (BE) 2017/459 dhe synoi shpërndarjen e kapaciteteve rritëse afatgjata në pikat ekzistuese ose të reja të ndërlidhjes (IP) përgjatë gjurmës së TAP dhe do të rrisë vëllimet e gazit të importuar në Europë.

Pikat e interkonjeksionit në fjalë janë: Kipoi (TR - GR), Komotini (GR), Nea Mesimvria (GR), Kucovë (AL), Relievi Rosckovec (AL), Fier (AL), dhe Melendugno (IT). Projekti i rritjes së kapacitetit parashikoi katër nivele të mundshme zgjerimi në hyrje në Kipoi (minimum, i kufizuar, i pjesshëm dhe i plotë), në varësi të nivelit të rezervimit, duke çuar në një zgjerim të mundshëm të plotë deri në 27 MSm³/D. Faza e detyrueshme ka nisur më 14 nëntor dhe ofertat patën afat për tu dorëzuar deri në janar 2023.

TAP është pjesë e Korridorit Jugor të Gazit, që transporton gaz natyror në Europë nga fusha e Shah Deniz II në Azerbajxhan. Duke u lidhur me gazsjellësin Trans Anatolian në kufirin greko-turk, TAP kalon Greqinë Veriore, Shqipërinë dhe Detin Adriatik përpara se të dalë në breg në Italinë Jugore për tu lidhur me rrjetin Italian të gazit natyror.

ENTRI RREGULLATOR I ENERGJISË

LETTER

TRANSPARENCA

Ligji Nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit në Shqipëri” rregullon të drejtën për të marrë informacion/dokumente të disponuara nga autoritetet publike. Synimi është promovimi i transparencës dhe llogaridhënies së autoriteteve publike.

Në përputhje me këtë ligj, janë publike të dhënat dhe kontaktet e Koordinatorit për të Drejtën e Informimit të Entin Rregullator të Energjisë, nëpërmjet të cilit është bërë e mundur përcjellja e informacionit dhe garantimi i transparencës përkundrejt kërkuësve, gjatë vitit që lamë pas. Ky informacion regjistrohet dhe mund të aksesohet lehtësisht në regjistrin e kërkesave, në kategorinë e Transparencës në web-in e ERE-s, i cili rifreskohet jo më vonë se çdo 3 muaj kalendarik.

Në vitin 2022, siç mund të shihni dhe nga grafiku i mëposhtëm, janë paraqitur 22 kërkesa, nga të cilat një është deleguar drejt autoritetit përgjegjës, dhe janë trajtuar dhe kthyer përgjigje brenda afateve të përcaktuara në ligj. Në një vështrim të përgjithshëm mbi regjistrin e kërkesave, vihet re që pjesa më e madhe e kërkesave kanë ardhur nga portale/gazeta.

Grafiku 2 – Llojet e kërkesave të ardhura në adresën e koordinatorit për të drejtën e informimit gjatë vitit 2022



NEWSLETTER

Enti Rregullator i Energjisë



MBI PËRZGJEDHJEN, EMËRIMIN DHE PROMOVIMIN NË DETYRË TË PERSONELIT TË ERE

Mbi përzgjedhjen, emërimin dhe promovimin në detyrë të personelit të ERE në përputhje me Ligjin nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar, përzgjedhja, emërimi dhe promovimin në detyrë i punonjësve të ERE-s, bazohet në procedurat e ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”. Sipas këtij ligji gjatë vitit 2022, janë realizuar 12 procedura të përzgjedhjes dhe emërimit të nëpunësve të ERE-s. Nga procedurat e konkursit për pozicionet të ndryshme në ERE, rezultuan 8 lëvizje paralele dhe 4 pranime nga jashtë shërbimit civil. Gjithashtu gjatë po këtij vitit, z. Petraq Lika, u bë pjesë e Bordit të Komisionerëve të ERE, emëruar në detyrë më datë 22.09.2022 si dhe më datë 22.12.2022 znj. Erjola Sadushi u riemërua për një mandat të dytë si Komisionere e Bordit të ERE-s.

SEANCA DËGJIMORE

Gjatë vitit që lamë pas janë zhvilluar 49 seanca dëgjimore të organizuara nga ERE, me qëllim marrjen e qëndrimit të palëve dhe zgjidhjen përfundimtare apo adresimin e zgjidhjes së ankesës apo kërkesave të palëve të interesit.

Pjesmarrës në seanca, në varësi të objektit, kanë qënë konsumatorë (15 raste) me qëllim zgjidhjen e ankesave të paraqitura në ERE si dhe subjekte të licencuar (34 raste). Ndër këto të fundit mund të përmendim jo vetëm seanca të zhvilluara me subjekte në kuadër të procesit të licencimit, por dhe me qëllim konsultimin apo përfitimin e këndvështrimit të palëve të interesit mbi rregullore apo kode të ndryshme të miratuara më pas nga ERE gjatë vitit 2022, apo dhe rishikimin apo përcaktimin e tarifave të ndryshme.

Vlen për tu përmendur që zhvillimi i seancave dëgjimore, qoftë me pjesëmarrje fizike të të ftuarve apo dhe nëpërmjet lidhjeve zoom, krijon hapësirë për palët për të sqaruar më tej këndvështrimin e tyre dhe për tu ballafaquar më njëri – tjetrin, nën drejtimin e përfaqësuesve të ERE-s, duke bërë shpesh herë që vetë palët të jenë më të qartë me rrugën që duhet ndjekur për adresimin apo zgjidhjen e objektit të seancës.

www.ere.gov.al

ANKESA

ERE punon për të mbrojtur konsumatorët e energjisë, duke siguruar që ata të trajtohen në mënyrë të drejtë, të barabartë dhe të përfitojnë nga një mjedis më i pastër dhe më i gjelbër. ERE është përgjegjëse për të koordinuar punën e saj me qeverinë, industrinë dhe grupet e konsumatorëve për të ofruar koston më të ulët për konsumatorët, eliminuar praktika e këqija dhe siguruar trajtim të drejtë për të gjithë konsumatorët, duke mundësuar konkurrencën dhe inovacionin, që ul çmimet dhe rezultojnë në produkte dhe shërbime të reja për konsumatorët. ERE ndërhyr me rregullim ligjor, aty ku është e nevojshme për të mbrojtur interesat e konsumatorëve dhe kryen hetime për sjelljen e të licencuarve, kur dyshon se ata mund të kenë shkelur një kusht të licencës së tyre, kërkesat e mbrojtjes së konsumatorit ose legjislacionin e miratuar nga ERE për këtë qëllim.

Një pjesë e rëndësishme e punës së ERE fokusohet në zgjidhjen e ankesave të klientëve të energjisë. ERE mbledh dhe përpunon statistika për numrin dhe natyrën e ankesave të konsumatorëve. Veçanërisht vitet e fundit, e më konkretisht gjatë viteve 2021-2022, ERE ka marrë një rol shumë më aktiv sa i përket kanaleve të komunikimit me konsumatorët. Këto kanale përfshijnë paraqitjen fizikisht në zyrat e ERE, adresimin e informacionit mbi statusin e ankesave apo informacione sipas nevojës së konsumatorit, nëpërmjet numrit të gjelbër, parashtrimin e një ankese me shkresë, ose edhe me email. Në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, ERE merr përsipër zgjidhjen e një ankese, pasi verifikon se kërkesa e paraqitur në ERE plotëson kriteret minimale për t'u trajtuar nga ERE, dhe pasi konstaton se çështja që paraqitet për shqyrtim përfshin një shoqëri të licencuar. Pasi analizon dokumentacionin e vënë në dispozicion nga konsumatorët, ERE e adreson ankesën tek i licencuari për marrjen e informacionit dhe dokumentacionit plotësues të nevojshëm që i shërben zgjidhjes së ankesës e lejon ERE-n të përpunojë të dhënat me qëllim gjenerimin e një zgjidhje ligjore të mbështetur në prova dhe në ligj.

Gjatë vitit 2022 në ERE janë regjistruar 189 ankesë/kërkesa të klientëve të Energjisë elektrike, të cilat i gjeni të kategorizuara në tabelën në të djathtë:

Tabela 3 – Llojet e ankesave / kërkesave

<u>Lloji i Ankesës / Kërkesës</u>	<u>Nr.</u>
<u>Kërkesa për informacion</u>	53
Ankesa për mbifaturim	36
Ankesa për dëm ekonomik	24
Vlerë referuese	8
Kontratë fiktive	7
Lidhje të reja	6
Ndryshim tarifimi	5
Të ndryshme	50
Total	189



Këto rregulla janë miratuar në datën 3 qershor 2022, nga Bordi Drejtues i SEE CAO, dhe i janë nënshtruar konsultimit të organizuar nga SEE CAO, gjatë të cilit çdo palë interesi ka patur mundësinë të japë komentet apo sugjerimet përkatëse. Gjatë këtyre konsultimeve të realizuara nga Zyra e Alokimit të Kapaciteteve të Interkonjeksionit me seli në Podgoricë, rezultoi se nuk pati asnjë propozim apo kërkesë për ndryshim të akteve të publikuara nga asnjë prej paleve të interesit. Aplikimi i këtyre rregullave filloi në vitin 2022 dhe do të shërbejë për alokimin e kapaciteteve që do të zhvillohen për vitin 2023. Këto rregulla bazohen në parime të vendosura në Traktatin e Komunitetit të Energjisë të nënshkruar dhe nga Shqipëria, në lidhje me harmonizimin e metodave për menaxhimin e konxhestioneve në Interkonjeksion.

Me vendimin Nr. 280, datë 01.11.2022 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, u miratuan "Rregullave të Harmonizuara të Alokimit të SEE CAO, për kufijtë Shqipëri - Greqi, Shqipëri - Mal i Zi dhe Shqipëri - Kosovë. Bazuar në këtë vendim, Rregullat e harmonizuara të alokimit të kapaciteteve të interkonjeksionit të miratuara me vendimin e bordit të ERE nr. 197, datë 26.11.2020 u aplikuan për ankandet mujore dhe ditore për periudhën nëntor - dhjetor 2022. Vendimin së bashku me rregulloren në gjuhën shqipe, mund ti shfletoni në linkun e mëposhtëm, në rubrikën [Vendimet Viti 2022](#).

Për çdo mospërputhje mes versionit në gjuhën shqipe dhe atij në gjuhën angleze, palët duhet t'i referohen versionit në gjuhën angleze i cili gjendet i publikuar në rubrikën konsultime në webin e ERE-s, në linkun [bashkëngjitur](#).

MIRATIMI I RREGULLAVE
TË HARMONIZUARA TË
ALOKIMIT TË
KAPACITETEVE TË
INTERKONJEKSIONIT PËR
ZYRËN E KOORDINIMIT
TË ANKANDEVE NË
ERUROPËN JUGLINDORE
(SEE CAO) PËR KUFIJTË
SHQIPËRI - GREQI,
SHQIPËRI - MAL I ZI DHE
SHQIPËRI - KOSOVË.

NEWSLETTER

Enti Rregullator i Energjisë

AKTIVITETE NDËRKOMBËTARE

Ndër prioritetet e ERE-s është dhe mbetet përfaqësimi sa më dinjitoz dhe aktiv i punës së Rregullatorit në aktivitetet rajonale dhe ato ndërkombëtare, duke patur si qëllim përputhjen dhe harmonizimin e praktikave të saj me praktikat e vendeve të rajonit dhe BE-së. Qëllimi i pjesëmarrjes në aktivitetet ndërkombëtare është konsideruar nga ERE si një ndër elementet kryesore që i shërben forcimit dhe bashkëpunimit institucional, rritjes së njohurive dhe eksperiencës së stafit të saj.



www.ere.gov.al

Gjatë vitit 2022, pjesa më e madhe e aktiviteteve janë zhvilluar me pjesmarrje fizike nga përfaqësues të niveleve/pozicioneve të ndryshme në ERE, por edhe nëpërmjet platformave online të komunikimit. Aktivitetet më të shumta janë zhvilluar nga partneri jonë rajonal MEDREG, dhe pjesmarrja ka qënë e shpeshtë si pasojë edhe e faktit që deri në përfundim të vitit që lamë pas, Kryetari i ERE-s, z. Petrit Ahmeti mbante njëkohësisht rolin e Presidentit të MEDREG. Gjatë asamblesë së fundit, përfaqësues të ERE u zgjodhën për dy vjeçarin e ardhshëm, të marrin pjesë në nivele të larta drejtuese të strukturave të kësaj organizate të rëndësishme. Komisionerja e ERE Znj.Sadushi është rizgjedhur të mbajë pozicionin e zv. kryetares së Grupit të punës së Konsumatorëve dhe Sekretarit të Përgjithshëm të ERE, z.Elton Radheshi, i është besuar kryesimi në bashkëpunim me Sekretariatit të Task Forcës së bashkëpunimit me platformat e UfM. Gjithashtu, Z. Radheshi u rikonfirmua në kryesimin e grupit të punës të REMIT në ECRB. Stafi i ERE-s ka marrë pjesë në mënyrë aktive në takimet e grupeve të punës përfshirë dhe drejtimin e tyre për konsumatorin si dhe takimet e grupeve të punës për marrëdhëniet institucionale, energjitë e rinovueshme, çështjet e gazit, elektricitetit etj.

Vlejnë për tu përmendur dhe pjesmarrje aktive në disa nga bashkëpunëtorë të tjerë të ngushtë të ERE-s si ECRB, ARERA, USAID, NARUC, ERRA, CEER; apo dhe pjesmarrje në aktivitete si OME Gas Platform, Panairi I GASTECH, Workforce Gender Equality, Takimin e 36-të të Forumit Europian të Gazit Natyror etj. Forcimi në vazhdimësi i këtyre marrëdhënieve dypalëshe, i ka shërbyer rritjes dhe bashkëpunimit institucional si dhe rritjes së njohurive dhe eksperiencës së stafit të insitucionit.

ENTIT RREGULLATOR I ENERGJISË

NEWSLETTER

AKTIVITETE RAJONALE

Kontratat e furnizimit me energji elektrike dhe roli i Entit Rregullator të Energjisë në mbrojtjen e konsumatorëve

Përfaqësuese të Entit Rregullator të Energjisë, ERE, morën pjesë në aktivitetin e organizuar nga Akademia e Konsumatorit në datë 07 maj 2022, si lektore dhe advokate të promovimit të informacionit me qëllim mbrojtjen e të drejtave të konsumatorëve të energjisë elektrike. Anëtarja e Bordit të ERE znj. Erjola Sadushi, dhe Drejtorja e Mbrojtjes së Konsumatorit në ERE znj. Julia Guga prezantuan për pjesëmarrësit, një pasqyrë të kuadrit rregullues të sektorit të energjisë elektrike që lidhej kryesisht me të drejtat e konsumatorit. Me qëllim arritjen e informacionit sa më pranë konsumatorit, përfaqësueset e ERE prezantuan mes të tjerave si pjesë të fushatës informative, broshurat informative, si dhe mundësitë e aksesit në informacion të konsumatorëve, nëpërmjet faqes zyrtare të ERE, www.ere.gov.al, si dhe rrjeteve sociale të saj.

Vizitë e Komisionit Parlamentar për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti të Kuvendit të Republikës së Kosovës

Enti Rregullator i Energjisë, nën kryesimin e Kryetarit z.Petrit Ahmeti, anëtarëve të Bordit si dhe Drejtuesve të strukturave kryesore, mirëpriti në datën 31 maj 2022 në ambjentet e ERE, Komisionin Parlamentar për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti të Kuvendit të Republikës së Kosovës, me kryesi të z. Ferat Shala. Gjatë këtij takimi, përfaqësuesit e të dy palëve diskutuan rreth nismave ligjore që do të ndihmonin në përafrimin e akteve të rregullimit të sektorëve të energjise elektrike dhe gazit të Shqipërisë dhe Kosovës duke patur në fokus fushat e veprimtarisë dhe të bashkëpunimit mes dy vendeve si dhe dy institucioneve përkatëse. Duke patur parasysh se në Tetor të vitit 2020 u themelua Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike (ALPEX), në bashkëpronësi të Operatorëve të Sistemeve të Transmetimit të Shqipërisë (OST) dhe Kosovës (KOSTT), përfaqësuesit e Komisionit Parlamentar të Kosovës, kërkuan të informohen më gjerësisht e nga afër në lidhje me rregullimin e sektorit energjistik në Shqipëri, duke vlerësuar si shumë të rëndësishëm vendosjen e bashkëpunimit reciprok mes dy vendeve, veçanërisht në kushtet e krizës energjitike që ka prekur vendet tona dhe të rajonit.

ENTIT RREGULLATOR I ENERGJISË LETTER

AKTIVITETE RAJONALE

Takim me Kryetarin e Bashkisë Elbasan

Kryetari i Entit Rregullator të Energjisë Z. Petrit Ahmeti së bashku me Bordin dhe stafin mirëpriti në datën 08 qershor 2022 në ambjentet e ERE-s, Kryetarin e Bashkisë Elbasan Z. Gledian Llatja, si dhe përfaqësues të strukturave drejtuese të kësaj bashkie me qëllim vendosjen e bashkëpunimit më të ngushtë mes institucioneve, sa i përkët çështjeve të interesit të përbashkët.

Përfaqësuesit e Entit Rregullator të Energjisë dhe Bashkisë Elbasan, diskutuan nga afër në lidhje me rolin që ERE ka në rregullimin dhe ekuilibrimin e interesave të konsumatorëve por edhe biznesit qoftë ai prodhues i energjisë elektrike apo jo, si dhe rolin e pushtetit vendor në adresimin e çështjeve që lidhen me interesat e këtyre kategorive, si një ndërmjetës por dhe aktor me impakt të drejtëpërdrejtë në komunitet.

ERE, prezantoi kuadrin ligjor rregullues të sektorit të energjisë elektrike si dhe vendosi theksin në rritjen e ndërgjegjësimit të institucioneve të administratës publike në lidhje me adresimin e çështjeve që impaktojnë komunitetin e që lidhen me ofrimin e një malli shumë të rëndësishëm, siç është energjia elektrike.

Nga ana e tij Kryetari i Bashkisë Elbasan, duke falenderuar ERE për organizimin e takimit dhe iniciativën, prezantoi disa nga problematikat e bashkisë të cilat lidhen me hapjen e tregut të energjisë elektrike dhe çmimin e energjisë për biznesin; shërbimin e cilësisë së furnizimit dhe investimeve në zonat rurale dhe turistike të kësaj bashkie, si dhe bashkëpunimin midis aktorëve si rregullatori dhe palë të tjera për të rritur koordinimin dhe aksesin në informimin e konsumatorëve.

ENTIT RREGULLATOR I ENERGJISË

NEWSLETTER

AKTIVITETE RAJONALE

Mikëpritje ZRRE i pasuar nga një takim dypalësh në Prishtinë

Në kuadër të miratimit të Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike të cilat do ti shërbejnë operimit të Bursës së energjisë elektrike në Shqipëri dhe Kosovë, Enti Rregullator i Energjisë mirëpriti në datën 25 nëntor 2022 përfaqësues të Rregullatorit të Kosovës (ZRRE) të cilët zhvilluan një seancë publike të përbashkët me palët e interesit të të dy vendeve, ndër të cilët mund të përmëndim AAES, AK, FTL, KOSTT, KURUM, KESH, KESKO.

Në fjalën e tyre hyrëse Kryetarët e Enteve përkatës, theksuan rëndësinë e këtyre rregullave në vijim të bashkëpunimit dypalësh duke qënë një hap i rëndësishëm për krijimin dhe bashkimin e tregut të energjisë elektrike. Ky proces daton nga qershori i viti 2018 ku operatorët e sistemeve të transmetimit OST, KOSTT dhe ERE dhe ZRRE nënshkruan Memorandumin e mirëkuptimit për bashkimin e tregut të një dite në avancë dhe asaj të së njëjtës ditë, bashkëpunim ky që do të vazhdojë dhe pas miratimit e rregullave dhe nisjes së operimit të ALPEX.

Gjatë këtij takimi, Administratori i ALPEX, bëri një përshkrim të përgjithshëm të rregullave të tregut të energjisë elektrike (rregullat e ALPEX përkufizimet, procedura e tregtimit si dhe procedura e klerimit dhe shlyerjes, të propozuara nga ALPEX dhe OST sh.a.). Këto rregulla do të mundësojnë më tej operimin e Bursës.

Më pas u dëgjuan komentet e palëve të interesit të ftuar në këtë takim, i cili do të pasohet dhe nga dëgjesa dhe takime të tjera teknike deri në miratimin e rregullave të sipërpërmendura nga rregullatorët përkatës sërisht në një mbledhje të përbashkët mes rregullatorëve.

Në vazhdimësi të takimit të mësipërm, në datat 27 dhe 28 dhjetor, Enti Rregullator i Energjisë, ERE, u mirëpriti nga homologët e Kosovës, ZRRE/ERO në Prishtinë. Gjatë këtyre dy ditëve, u zhvillua një mbledhje e përbashkët me ZRRE ku palët pjesmarrëse shqyrtuan dhe njëherë, diskutuan dhe miratuan kuadrin rregullator që do t'i shërbejë operimit të Bursës së Energjisë, ALPEX, si dhe bashkimit të tregut të energjisë elektrike. Kryetarët e Rregullatorëve të Shqipërisë dhe Kosovës, Z.Ahmeti dhe Z.Fejzullahu gjatë fjalës së tyre falenderuan palët pjesmarrëse dhe theksuan rëndësinë e këtij procesi jo vetëm për Shqipërinë dhe Kosovën, por dhe për rajonin. ALPEX pritët të fillojë me operimin e tregut të ditës në avancë në Shqipëri, dhe më pas, brenda një periudhë dy mujore do të operojë me tregun e bashkuar të të dy vendeve, për një periudhë të shkurtër në kushtet e Dry Run, për të vijuar më tej me operim të plotë.

NEWSLETTER

Enti Rregullator i Energjisë

Gjatë vitit 2022, rrethanat e veçanta në të cilat u gjend vendi por dhe bota për shkak të emergjencës energjitike, bënë që ERE ti japë më shumë rëndësi publikimit të informacionit që tashmë gjendet në web-in zyrtar, nëpërmjet broshurave informative dhe në rrjetet sociale, me qëllim komunikimin sa më pranë konsumatorit të informacioneve të përmbledhura me fokus çështjet me ndjeshmëri më të lartë për konsumatorin, si kushtet e lidhjes në rrjet, pezullimit apo ndërprerjes së një kontrate furnizimi, e drejta për të zgjedhur apo ndryshuar furnizuesin, kushtet për sigurimin e një lidhje me rrjetin e shpërndarjes, standardet e cilësisë së shërbimit, e drejta për t'u ankuar. Broshurat e sipërcituara gjenden të publikuara në ambjentet e ERE por edhe në faqen zyrtare dhe në rrjetet sociale, me qëllim arritjen në një numër sa më të madh konsumatorësh të informacionit të nevojshëm. Gjithashtu, u përgatitën materiale informuese mbi kursimin e energjisë, me qëllim rikujtesën e detajeve të përditshme që në bashkëpunim mund të bëjnë ndryshim me rëndësi në konsumin e përgjithshëm të energjisë. Edhe këto të fundit mund ti gjeni lehtësisht në web-in zyrtar të ERE-s apo rrjetet tona sociale.

FUSHATA SENSIBILIZUESE



Për më shumë na ndiqni në:



[Enti Rregullator i Energjisë](#)



[@enti_rregullator_energjisë](#)



www.ere.gov.al